

Promovohet monografia "Mulliçi"

Të martën, me fillim nga ora 11, në ambientet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare në Prishtinë u promovua monografia e autorit gjerman Johann Gunther, e cila i kushtohet njërit nga artistët më të njohur të Kosovës, Luan Mulliqit. Njohësve dhe adhuruesve të skulpturës së Mulliqit,

gjatë promovimit të Monografisë iu drejtua autori i saj, Johann Gunther, i cili për këtë rast erdhi enkas nga Vjena. Ndryshe, Monografia Mulliqi përmban gjithë jetën dhe veprën e artistit Luan Mulliqit, përfshirë këtu edhe veprimtarinë e tij në fushën e gjerë të kulturës.

